

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

314 /

K



**LULE DRITE**

**POEZI**

PANDELI KOÇI

814-1  
K77

PANDELI KOÇI

# LULE DRITE

poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## K Ë N G Ë

Për Partinë lule drite  
këndona, zemër, këndona,  
për Partinë, grusht çelike,  
këndona, zemër, këndona.

Për Enverin rreze drite  
këndona, zemër, këndona,  
për Enverin zemërshqipe,  
këndona, zemër, këndona.

Për Atdhenë — shullër'i diellit  
këndona, zemër, këndona,  
për Atdhenë kështjellë baroti,  
këndona, zemër, këndona.

Si s'këndove kurrë moti,  
këndona...

## PËRRENJTË

Derdhen e derdhen përrenjtë malorë...

Me 25 prill 1976

buruan përrenj të rinj:  
derdhi furrnalta e parë

shqiptare

përrenj të zjarrtë metali,

Peisazhi i socializmit

pa ata s'do të kishte kuptim.



## FLAMURI YNË

Nga palët flakëruese liria rrezatonte,  
agimin përshëndeste në shekujt errësirë...

Kur plaku patriot në Vlorë e shpalosi,  
shqiptari i tha botës:

«Këtu është Shqipëri!»

Por duhej ende gjak!

Por duhej, shokë, Partia — zjarr revolucioni,  
flamuri të përllindej, liria të ngadhnjente,  
liria e vërtetë pa mbret edhe borgjezë!

Flamuri ynë i kuq përjetë i kuq do mbetet,  
si gjaku i dëshmorëve ndër shekuj burim drite;  
shqiponja jonë e lirë  
përherë më lart do ngjitet —  
qielli i komunizmit për të është fole.

## THELLË NË ZEMËR

Pluhur verës, dimrit baltë,  
verës, dimrit — djersë e artë,  
thellë në zëmër — dritë e mjaltë.

Shkundim pluhurin, baltën fshijmë,  
veprat rriten, vetëtijnë,  
mbi gjithçka rritim Njerinë.

Është e ç'është: dhe ujë dhe gur,  
hekur-o, i shenjtë hekur  
sot të kemi si askurrë.

Nuk është thjesht çelik i shkrirë,  
është flamur i zjarrtë, i lirë,  
ëndrra jonë e lashtë, e dliërë.

Ndaj punëtori çelik kreu,  
se kërkon parmendë dheu,  
do përherë mburojë atdheu.

Derdhu, rridh çelik shqiptar,  
gjaku ynë je në damar  
thellë në zemër: flakë e zjarr.

KJO ËSHTE NJË URË QË E NGRITËM PËR  
NJË DITË

Betononim.

Ditë dhe natë — barazi me ditë.

Harruam lodhjen, muskujt u shndërruan në shufra  
çeliku;

folëm dhe s'folëm për dashuritë.

Në këmbët e urës, kurban djersa jonë.

Dhe derdhëm beton

përzier me thirrjet, këngët dhe sharjet.

(Sharjet për shefin e furnizimit, që

atë natë kishte shkuar në dasmë të

djalit të hallës e pinte raki mare

dy herë të zierë në Gostimë.)

Mbi të gjithë thërriste fjala «Furnizim»,

Hënën dhe yjtë i kishin ndërruar me projektorë.



Ulërima rrëqethëse e vibratorëve  
kthehej e përdridhej në rrënkim  
(dhembjet e lindjes kudo janë të ngjashme)  
vetëshkarkueset vinin e shkonin,  
shkonin e vinin zinxhirë.  
Shkarkohej betoni me rrapëllimë,  
si tej në Fierzë shkarkoheshin gurët me bубullimë.

Aty vërdallë pafuqinë e talentit ndjeu një  
shkrimtar.

Përse vallë kafshoi buzët vullnetarja Norë?  
Askush s'e mori vesh dhëmbjen thikë;  
dhëmbja e veshkave i tha: ik!  
Asaj iu saldua lopata në dorë.  
(Ishte pushka e nënës shndërruar në lopatë.)

Nën këtë urë nuk kaloi ujë  
po djersa jonë vullnetare,  
paçka se shefi piu një fuçi me raki mare.  
Nën këtë urë s'do të kaloi lum,  
po treni me metal,  
që si lumi valërrahur nuk fle kurrë.

U shpërnda mjegulla në agim  
dhe befaz

**u shfaq si në përrallë**

**një vegim:**

**Ura,**

**ende e lagët, ende e përgjumur**

**si një mëz gjigand i porsalindur —**

**ura.**